



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datë: 01.07.2013

Nr. 0204-821

**PËR:** Burim Berisha, Kryetar i Komunës së Fushë-Kosovës  
Jakup Tërnavë, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës

**LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË FUSHË-KOSOVËS, Nr. 75, Pranuar me datë, 24.06.2013.**

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 75 të miratuar me datë 30.05.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale .

Akti juridik i listuar si në vijim, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi nr. 75, aprovohet në parim propozimi për ndërrimin(këmbimin) e ngastrave kadastrale.

Me respekt,

**Slobodan Petrović,**  
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

**Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL**  
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së  
Arkivit të MAPL-së.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

Datum: 01.07.2013  
br. 0204-821

**Za:** Burim Berisha, Gradonačelnik opštine Kosovo Polje  
Jakup Tërnavë, Predsedavajući Skupštine opštine Kosovo Polje

**Predmet:** Potvrda zakonitosti odluke opštine Kosovo Polje, br. 75, odobreno dana ,  
24.06.2013.

Poštovani/e

Ministarstvo administracije lokalne samouprave u skladu sa njenim mandatom, definisano zakonom o lokalnoj samoupravi br. 03/z-04, dodatak XII uredbë Vlade 02/2011 o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije Premijera i Ministarstva nakon razmatranja odluke br. 75 odobreno dana 30.05.2013, POTVRĐUJE zakonitost ovog akta i procenjuje da je isti taj u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je , kao što sledi,

- Odluka br. 75, usvaja se u principu predlog o izgradnji (razmeni ) katastarskih parcela .

Sa poštovanjem,

**Slobodan Petrović,**  
Zamenik premijera i Ministar MALS-a,


**Kopije:** Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a  
Rukovodiocima odeljenja MALS-a  
Arhivi MALS-a.





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE  
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 04.06.2013

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.05.2013, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 55, të datës 29.04.2013, paraqitur nga Drejtori për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi dhe të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar nënin 11, nenin 40, pika 40.2 shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 11 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës, Nr. 04/L-144 (Gazeta Zyrtare Nr. 35/2012), nenin 21 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shpronësimin e pronës së paluajtshme Nr. 03/L-95 (Gazeta Zyrtare Nr. 91/2010), nenin 27, pika shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet në parim propozimi për ndërrimin (këmbimin) e ngastrës kadastrale Nr. 72514036-00589-134 e evidentuar në Fletën Poseduese me numër të certifikatës 25-184, në sipërfaqe prej S = 00.08.20 ha, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, P.SH. Kuvendi Komunal dhe pjesës në sipërfaqe prej S = 00.05.30 ha, nga ngastra kadastrale Nr. 72514036-00589-1 në sipërfaqe totale prej S = 00.46.42 ha e evidentuar në Fletën Poseduese me numër të certifikatës 25-183, në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, P.SH. Kuvendi Komunal, me ngastrën kadastrale Nr. 72514003-00464-0 në sipërfaqe prej S = 00.78.48 ha e evidentuar në Fletën Poseduese me numër të certifikatës 25-181, në Zonën Kadastrale Harilaç, pronë e Bashkësisë Fetare Islame.
  - II. Ndërrimi (këmbimi) i pronave të paluajtshme të cekura në pikën një (1) të vendimit, kërkohet të bëhet për realizimin e projektit me interes të përgjithshëm 'Ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujërave të zeza', në fshatin Harilaç.
  - III. Kërkohet nga Departamenti i Tatimit në Pronë, në Ministrinë e Financave që të bëjë vlerësimin e pronave të paluajtshme të cekura në pikën (1) të vendimit.
  - IV. Kryerja e procedurave tjera, është në kompetencë të Drejtorisë për Financa, Buxhet dhe Pronë dhe Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi.
  - V. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e aprovimit, nga Kuvendi i Komunës.
- Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit, Ministrisë së Financave - Departamentit për Tatimin në Pronë, Drejtorisë për PUKGJ, Drejtorisë për FBP dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

